



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:228013

Datë: 02.02.2024

Numri i dokumentit: 05277490

P. 2023:064180

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka, me Bashkëpunëtorin profesional Ismail Kuçi, në çështjen penale kundër të pandehurit B.D, i shpallur fajtor për veprën penale në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.1547/2021 të datës 13.12.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, publik më datë 23.01.2024, në praninë e Prokurori të Shtetit Fatos Ajvazi, të pandehurit B.D, palëve të dëmtuara E.D dhe E.D, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë **02.02.2024** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: B.D me vendbanim në rrugën'' ... Komuna e Kaçanikut, , i lindur më ... nga i ati A... e ëma S..., e gjinisë K..., ka të kryer shkollën e fillore, i pa punë, beqar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Kosovës, me numër personal ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 25.09.2021, rreth orës 21:20, në rrugën ‘Ismail Raka’ në Kaçanik, në kafiterinë “...”, në bashkëkryerje dhe me dashje, të pandehurit iu shkaktojnë lëndime të lehta trupore të dëmtuarve E.D, G. D.dhe E.D, në atë mënyrë që deri sa kanë qenë në kafiteri ulur në një tavolinë duke pirë pije, në tavolinën tjetër kanë qenë të ulur të pandehurit, ku më pas i dëmtuari E.D takohet në mes të kafiterisë me të pandehurin Sh.K, deri sa ishin **duke biseduar vjen i pandehuri B.D i cili fillimisht e godet me grusht të dëmtuarin E.D**, pastaj i pandehuri S. L. e godet e grushte nga mbrapa në pjesën e kokës të dëmtuarin E..., pastaj i pandehuri S. L. e kap për fyti të dëmtuarin **E.D dhe nga mbrapa i pandehuri B..., B... dhe Sh... e godasin në pjesën e kokës dhe shpinës të dëmtuarin D...**, i pandehuri B. B. e godet me grushte në pjesën e hundës dhe fytyrës të dëmtuarin G. D., në atë moment fillon përlëshja, të pandehurit të lartcekur godasin të tre të dëmtuarit me grushte dhe shqelma duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit E.D edhe atë: gërvishtje në krahun e djathtë dhe skuqje nën syrin e majtë, të shkaktuar nga ndonjë mjet i fortë dhe i rëndë mbretës.

- Me këto veprime në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Duke u bazuar në dispozitën e lartcekur dhe nenin 2, 17, 39, 40, 42, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 361, 365 dhe 453 të KPPK-së i shqipton:

DËNIM ME BURGIM

I. Dënim me burgim 90 ditë (Nëntëdhjetë) ditëve, i cili do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

II. Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

III. Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale (përpilimin e ekspertizës mjeko ligjore) të paguaj shumën 20.00€, në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën 50.00€, si dhe për Fondin për Kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën 20.00€, të gjitha këto shuma t’i paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1547/2021 të datës 13.12.2021 kundër të pandehurve B.D, B. B., Sh.K, S. L., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ka propozuar që të njëjtit t'i shpall fajtor dhe t'u shqiptohet sanksioni penal konform ligjit në fuqi.

Në seancën e datës 07.02.2023 është veçuar procedura penale ndaj të pandehurit B.D.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze për të pandehurin B.D mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 23.01.2024.

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës ka deklaruar se penduar për veprimet e kryera, dhe ju ka kërkuar falje palëve të dëmtuara dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsëris vepra penale ne te ardhmen.

Prokurori i Shtetit ka shprehur mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë, ka theksuar nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që vullnetarisht i njëjti u deklarua dhe pranoi fajësinë pa qenë i ndikuar dhe i imponuar nga askush pranimi i fajësisë mbështetet edhe ne faktet dhe provave mbi bazën e të cilave është ngritur aktakuza dhe është në pajtimin e nenit 242 të KPP-së, Andaj kërkoj nga gjykata që ta aprovoj pranimin e fajësisë të pandehurin ta shpallë fajtor për veprën e cila i vihet në barrë dhe ndaj tij duke marrë për bazë rrethanë të cilat ndikojnë në matjen e dënimit të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK së, Në këtë rast si rrethanë rënduese shkallën e lartë të dashjes dhe brutalitetin e shfaqur gjatë kryerjes së veprës penale e cila vërtetohet nga pamjet e video kamerave që janë siguruar në vendin e ngjarjes ku i pandehuri shihet tej mase i acaruar dhe me sjellje brutale duke i goditur të dëmtuarit pa mëshirë, faktin se vepra penale është kryere në bashkëkryerje dhe në grup të më tepër se 2 persona, faktin se i pandehuri është recidivist dhe ka qenë i dënuar edhe më parë nga kjo gjykatë për vepra të tilla dhe të natyrave të tjera ku këtë fakt gjykata mundë ta siguroj nga data baza e të dhënave penale, kurse si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë nga i pandehuri por që kjo rrethanë nuk do t'ju merret si rrethanë veçanërisht si lehtësues pasi që i pandehuri i gjendur Pra provave të pa kontestuar nuk kishte rrugë tjetër për veç se ta pranoi fajësinë, shprehen e

pendimit të tij dhe kërkim faljen ndaj të dëmtuarve premtimin se nuk do të përsëris më veprime të tilla dhe mbi bazën e këtyre rrethanave që u përmenden ma lartë gjykata të shqiptoj dënim me burgim efektiv jo më pak se 1 vit pasi që në këtë rast vetëm me këtë lloj të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimi veçanërisht te i pandehuri me këtë dënim do të arrihet risocializimi i tij dhe do të ndikoj në të ardhmen që i njëjti në të ardhmen të jetë shumi kujdesshëm të cilin mos të merr as një veprim i cili do ta shpije ndesh me ligjin.

Pala e dëmtuar E.D lidhur me pranimin e fajësisë deklaron: i bashkëngjitem ndjekës penale dhe kërkoj dëm shpërblim

Pala e dëmtuar E.D lidhur me pranimin e fajësisë deklaron: i bashkëngjitem ndjekës penale.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 242 par 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: I pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin e figurës së veprës penale gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në mënyrë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Rrethanat për matjen e dënimit

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese gjeti se i pandehuri e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, shprehjen e pendimit për veprën e kryer, premtimin se nuk do të përsërisë vepra penale, si rrethana rënduese mori për bazë faktin se i pandehuri është recidivist i dënuar me Aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës Themelore Ferizaj Dega Kaçanik P.nr.138/18 të datës 03.02.2020. Po ashtu ka qenë i akuzuar edhe për vepra penale të ngjashme, të cilat i ka zgjidhur përmes procedurës së ndërmjetësimit 2022:274602, 2023:211922, 2021:013352. Shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të pandehurit në drejtim të palëve të dëmtuara edhe pse nuk ka të dhëna se ka qenë i provokuar nga ana e palëve të dëmtuara.

Sipas vlerësimit të Gjykatës dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit, duke i marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, të pandehurit i shqiptoi dënimin me burgim duke e marrë për bazë minimumin dhe maksimumin dhe qëllimin e dënimit dhe duke u bazuar në rrethanat lehtësuese ka vlerësuar se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Po ashtu ka marrë për bazë faktin se dënimet e tjera dhe zgjidhja e qeshjeve përmes procedurës së ndërmjetësimit nuk kanë pasur efekt te i pandehuri në rehabilitimin e tij.

Kërkesat pasurore juridike

Duke u bazuar në nenin 462 të KPP-së, pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata vendimin mbi shpenzime e procedurës dhe paushallit gjyqësor e mori konform neneve 450 dhe 452 të KPPK-ës.

Gjykata vendimin mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit e mori konform nenit 36 paragrafi 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P. 2023:064180 datë: 02.02.2024

Procesmbajtësi:
Ismail Kuçi

Gjyqtari:
Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2021:228013
Datë: 02.02.2024
Numri i dokumentit: 05277490